



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1140
Data e Vendimit: 29.11.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) "BIMI" ING SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shtuarja me zhavorr për rrugët e rendit të katërt" me numër të prokurimit VU644-24-10541-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisë, zv. Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit z Agim Sheqiri me datën 29.11.2024, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jo e plotë ankesa e OE."BIMI ING"SH.P.K., me nr. të protokollit 2024/1140, e datës 22.11.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Shtuarja me zhavorr për rrugët e rendit të katërt" me numër të prokurimit VU644-24-10541-2-1-1, inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisë.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Shtuarja me zhavorr për rrugët e rendit të katërt" me numër të prokurimit VU644-24-10541-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 22.11.2024, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE."BIMI ING SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit me "Shtuarja me zhavorr për rrugët e rendit të katërt" me numër të prokurimit VU644-24-10541-2-1-1, inicuar nga Komuna e Vushtrrisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka

kryer pagesën siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesën e lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, edhe pse zyra për pranimin e ankesave me datën 22.11.2024 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës se pas ekzaminimit të shkresave që i keni bashkangjitur në platformë OSHP, ka konstatuar se nuk keni kryer pagesën siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 69 të rregullores 001/2022 të prokurimit publik., citojmë nenin 69.2 “Në përputhje me nenin 118 të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife të ankesave në OSHP. a. Kurdo që ankesa ndërlihet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5, 000 Euro”. andaj luteni që afatin e mbetur të na e përcjellin dëshminë lidhur me pagesën **në të kundërtën Ankesa do të refuzohet**. Për të cilën OE ankues “Eng Bau” SH.P.K.lidhur me emailin e dërguar nuk ka kthyer përgjigje.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE."BIMI ING" SH.P.K., e datës 22.11.2024 (protokoll 1140/2024), për aktivitetin e prokurimit me titull “Shtruarja me zhavorr për rrugët e rendit të katërt” me numër të prokurimit VU644-24-10541-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Vushtrrisë, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankesë përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Shtruarja me zhavorr për rrugët e rendit të katërt” me numër të prokurimit VU644-24-10541-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veprojnë konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Zv. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Agim Sheqiri
U.D. Kryesues i Sekretariatit

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - BIMING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: